



SEKTORI I MINIERAVE DHE MINERALEVE NË REPUBLIKËN E KOSOVËS

(2017, 2018 dhe 2019)

DHJETOR 2020

Titulli: Sektori i minierave dhe mineraleve në Republikën e Kosovës (2017, 2018 dhe 2019)

Autore: Albana Hasani

Viti i botimit: Nëntor 2020

Dizajni: Ardit Berisha

Publikuar nga: Lëvizja FOL

Andrea Gropa nr.35 Prishtina 10000, Republika e Kosovës

info@levizjafol.org +386 (0)49 131 542

FOL



Pro Open
Koalicioni për Hapje të
të Dhënave dhe Ligjvënien
në Prokurim Publik

Publish 
What You Pay

Të drejtat e autorit © 2020. Lëvizja FOL. Të gjitha të drejtat e rezervuara. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem të ruajtjes së të dhënave apo të transmetohet, në asnjë formë apo mënyrë elektronike, mekanike, fotokopjuese, incizuese apo tjetër, pa pëlqimin paraprak me shkrim nga ana e botuesit.

TABELA E PËRMBAJTJES

1	Hyrje
2	Korniza ligjore
4	Situata e përgjithshme në sektorin e minierave dhe mineraleve në Republikën e Kosovës
6	Shuma e të hyrave të inkasuar nga kompanitë minerare në buxhetin e shtetit (2017,2018 dhe 2019)
10	Lirimi i pagesës së rentës minerare
11	Numri i licencave dhe lejeve të lëshuara për kompanitë minerare (2017,2018 dhe 2019)
13	REKOMANDIME

HYRJE

Lëvizja FOL, si anëtare e koalicionit Pro Open, me përkrahjen e Publish What You Pay, ka analizuar numrin e licencave të lëshuara gjatë viteve 2017, 2018 dhe 2019 për kompanitë minerare, si dhe shumën e të ardhurave që kanë hyrë në Buxhetin e Republikës së Kosovës nga veprimtaria e kompanive minerare gjatë këtyre viteve.

Ndonëse e vogël në sipërfaqe, Kosova ka resurse të mëdha minerare të cilat kanë luajtur rol kyç në zhvillimin ekonomik të vendit, prandaj edhe shfrytëzimi racional dhe menaxhuar i këtyre resurseve duhet të jetë një prej prioritetëve parësorë të vendit. Projektimi i një strategjie të mirëfilltë nacionale minerare, planifikimi efikas i shfrytëzimit të resurseve nga industria minerare, harmonizimi i ligjeve pozitive të sektorit minerar me legjislacionin e Bashkimit Evropian, forcimi i mekanizmit monitorues të sektorit minerar, fushata e tërheqjes së investitorëve dhe luftimi i operimit jo-formal, mbeten sfidat kryesore të institucioneve relevante të Republikës së Kosovës.

Obligimi për transparencë dhe llogaridhënie mbi paranë publike paraqet parakusht kryesor të qeverisjes së mirë. Prandaj qëllimi i këtij raporti është që të krijohet një pasqyrë e qartë për tatimpaguesit kosovarë lidhur me atë se sa është kontributi nga ana e sektorit të minierave dhe mineraleve mbi Buxhetin e Republikës së Kosovës, si një prej sektorëve më të rëndësishme dhe më fitimprurëse në Kosovë, si dhe të pasqyrohet numri dhe lloji i licencave që lëshohen çdo vit për veprimtarinë e kompanive minerare. Po ashtu, pjesë e këtij raporti është edhe përmbledhja kryesore e korpusit të ligjeve që e rregullojnë aspektin ligjor të sektorit minerar, si dhe në formë përmbledhëse është përshkruar situata e përgjithshme në sektorin e minierave në Republikën e Kosovës.

Të dhënat e paraqitura në këtë përmbledhje kryesisht janë bazuar në raportet vjetore të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPM), në të dhënat e publikuara në ueb-faqen zyrtare të Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit (ish Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik), si dhe në përgjigjen në Kërkesën për Qasje në Dokumente Publike të drejtuar KPM-së. Ndërkaq, të dhënat në lidhje me të hyrat buxhetore nga ky sektor në Buxhetin e Republikës së Kosovës për periudhën tre vjeçare (2017, 2018 dhe 2019) janë krahasuar me buxhetet fillestare të viteve përkatëse, respektivisht se në sa përqind kontribuon sektori i minierave në shumat e përgjithshme të këtyre buxheteve, si dhe nga cilat pagesa janë arritur këto të hyra.

KORNIZA LIGJORE

Në drejtim të etablimit të infrastrukturës ligjore për sektorin minerar, Kuvendi i Republikës së Kosovës ka sjell një varg ligjesh dhe aktesh nënligjore. Aktivitetet e industrisë minerare në Kosovë, pra, rregullohen me Ligjin 03/L-163 për Miniera dhe Minerale (të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-158 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Minierat dhe Minerale), si dhe me Ligjin Nr. 05/L-062 për Siguri në Punë në Veprimtarinë Minerare.

Ligjin 03/L-163 për Miniera dhe Minerale, si ligj bazë me të cilin rregullohen këto aktivitete, ka hyrë në fuqi në gusht të vitit 2010. Qëllimi i këtij ligji është hulumtimi, nxjerrja dhe pasurimi i lëndëve minerare përmes rregullimit dhe mbikëqyrjes së personave të angazhuar në industrinë minerare, si dhe rregullimi i mbledhjes, menaxhimit dhe arkivimit të të dhënave gjeo-shkencore.

Në pajtim me dispozitat e këtij ligji, për rregullimin e aktiviteteve minerare në Republikën e Kosovës kompetente është Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPMM), i cili fillimisht ishte themeluar në vitin 2005. Pra ky institucion është autoriteti përgjegjës për të siguruar hulumtimin dhe shfrytëzimin e rregullt të resurseve minerale në Kosovë dhe shfrytëzimin optimal të tyre.

Përveç kësaj, ky institucion ka edhe kompetenca dhe përgjegjësi të tjera, të cilat janë paraparë në nenin 56 të Ligjit për Miniera dhe Minerale. Ndër to përmendet lëshimi, transferimi, vazhdimi, pezullimi dhe revokimi i licencave dhe lejeve, themelimi dhe mirëmbajtja e një kadastrit të minierave dhe një baze të të dhënave GIS që përmban të dhëna gjeografike, gjeologjike dhe të dhëna të tjera relevante ekonomike si dhe të gjithë titujt ekzistues të mineraleve dhe të drejtave minerare, si dhe nxjerrjen e rregullave për organizimin dhe veprimtarinë e brendshme të KPMM-së.

Në bazë të nenit 5 të Ligjit për Miniera dhe Minerale, pas përmbushjes së kushteve për lëshimin e tyre KPMM-ja mund të lëshojë leje dhe licenca, sikurse licenca për hulumtim, licenca për mbajtjen e të drejtave, licenca për shfrytëzim, leje për ushtrimin e aktiviteteve të veçanta, licenca për shfrytëzim zejtar, licenca ose leje në interes të publikut. Sipas këtij ligji, leja paraqet një autorizim zyrtar me shkrim të lëshuar nga KPMM-ja për ushtrimin e aktiviteteve të veçanta.

Ndërkaq sipas nenit 87 të po këtij ligji, të gjitha rentat minerare, taksat dhe pagesat e tjera që i janë paguar ose që janë pranuar nga një autoritet publik, shndërrohen në “para publike” sipas Ligjit mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, dhe trajtohen në përputhje me dispozitat e atij ligji.

Me Ligjin Nr. 05/L-062 për Siguri në Punë në Veprimtarinë Minerare synohet përmirësimi sistematik i sigurisë dhe shëndetit të punëtorëve në punë, parandalimi i lëndimeve në punë, sëmundjeve profesionale dhe sëmundjeve tjera që ndërlidhen me punën e sektorit minerar.

Në pajtim me Ligjin për Miniera dhe Minerale dhe me ndryshim/plotësimet e bëra, Komisioni për Miniera dhe Minerale dhe Ministria e Zhvillimit Ekonomik kanë nxjerrë edhe një varg aktesh nënligjore. Ndër to mund të përmenden Udhëzimi Administrativ për Marrëveshje, Shtyrje dhe Përrjashtimin e Pagesës së Rentës Minerare, Udhëzimi Administrativ për Taksat Administrative, Rregullorja për Sigurinë

Minerare, Rregullorja për Administrimin e Mbeturinave Minerare, Rregullorja për Organizimin dhe Funksionimin e Institutit Gjeologjik të Kosovës si dhe Udhëzimi Administrativ për Klasifikimin dhe Vlerësimin e Resurseve dhe Rezervave Minerare dhe Mbajtja e Evidencës së tyre. Me këto akte nënligjore në mënyrë më të specifikuar rregullohen çështjet e caktuara normative që rrjedhin nga dispozitat e ligjeve gjegjëse.

Ministria e Zhvillimit Ekonomik në vitin 2012 kishte nxjerrë Strategjinë Minerare të Republikës së Kosovës për vitin 2012-2025, në të cilin është vlerësuar gjendja aktuale, sfidat që duhet të përballojnë institucionet, si dhe masat e programuara për shfrytëzimin racional të resurseve minerale.

¹ Ligji 03/L-163 për Miniera dhe Minerale, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, 2010.

²Po aty.

³Ligji Nr. 05/L-062 për Siguri në Punë në Veprimtarinë Minerare, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, 2016.

SITUATA E PËRGJITHSHME NË SEKTORIN E MINIERAVE DHE MINERALEVE NË REPUBLIKËN E KOSOVËS

Sektori i minierave dhe mineraleve në Republikën e Kosovës është një prej shtyllave kryesore në të cilën mund të mbështetet ekonomia e vendit.

Republika e Kosovës në territorin e vet disponon me pasuri të shumta minerare, prej të cilave mund të veçohen qymyri (linjiti), mineralet e plumbit, zinkut, argjendit dhe arit, mineralet silikate të nikelit dhe kobaltit, të hekur - nikelit, boksitit, manganit, magnezitit dhe një numër i konsiderueshëm i mineraleve jo-metalore, industriale dhe materialeve gjeologjike ndërtimore.

Qymyri (Linjiti) është resursi më i rëndësishëm energjetik i Kosovës. Ai kontribuon me 97 % të prodhimit të energjisë së tërësishme elektrike, gjersa pjesa tjetër e prodhimit rreth 3%, është e bazuar në hidrocentrale. Kosova zë vendin e pestë në botë sa i përket rezervave të vërtetuara të linjitit. Vendburimet më të rëndësishme qymyrmbytëse në territorin e Republikës së Kosovës janë: Baseni i Kosovës, Baseni i Dukagjinit dhe Baseni i Drenicës.

Resurset e vlerësuara të qymyrit në gjithë Kosovën janë rreth 12.5 miliardë ton, që nga aspekti ekonomik konsiderohen me leverdi të madhe fitimprurëse për tu menaxhuar dhe shfrytëzuar. Aktualisht pranë KPMM-së për shfrytëzimin e lëndëve minerale energjetike është e licencuar vetëm “Korporata Energjetike e Kosovës – KEK” e cila bënë shfrytëzimin sipërfaqësor të linjitit për nevojat e prodhimit të energjisë elektrike të vendit.⁵

Nga vështrimi gjeologjik, linjiti i minierave të Kosovës është një nga vendburimet më të favorshme të linjitit në Evropë. Raporti mesatar i heqjes së 1.7m³ mbulese për 1 ton qymyr dhe në total rezervat e vlerësuara ekonomikisht të shfrytëzueshme përfaqëson një nga më të pasurit në Evropë, që do të siguroj prodhimin e energjisë elektrike për dekadat e ardhshme.⁶

⁴ Të dhëna të marra në ueb-faqen zyrtare të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale, <https://www.kosovo-mining.org/resurset-minerale/vendburimet-minerale/>.

⁵Raporti Vjetor 2019 i Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale.

⁶Po aty.

Nikeli dhe kobalti janë kryesisht të përhapura në pjesën qendrore të Kosovës (afër Gllavicës, në veri të Magurës dhe në Çikatovë), ndërkaq kromi gjendet në regjionin e Gjakovës, Brezovicës. Vendburimi më i njohur i xeheve të kromit në Kosovë, ka qenë miniera e kromit Deva tani e shfrytëzuar, e cila gjendet në afërsi të kufirit me Shqipërinë.⁷

Në Kosovë dallojmë një numër të caktuar të minierave të zhvilluara si dhe një numër i vendburimeve më parë të vlerësuara, por të pazhvilluara. Miniera të zhvilluara janë miniera “Trepça” në Stantërg, Hajvalia, Badofci, Kizhnica, Artana, Belloberda dhe Cërnaci.⁸

Duhet të theksohet se prej shumë lëndëve minerale që posedon Kosova, vitet e fundit në një formë apo tjetrën janë duke u shfrytëzuar mineralet metalore (Pb-Zn-Ag, Au), mineralet energjetike (qymyr) dhe mineralet jo-metalore (andezit, gëlqeror, bazalt, dunit, rreshpe, rërë dhe zhavorr, rërë kuarcore, mergelë, argjilë, etj.)⁹

Në tabelën e mëposhtme në mënyrë grafike është shfaqur trendi i shfrytëzimit të lëndëve minerale gjatë vitit 2017, 2018 dhe 2019, të shprehur në ton.




Figura 1. Trendi i shfrytëzimit të lëndëve minerale gjatë vitit 2017, 2018 dhe 2019 të shprehur në ton.

Gjatë vitit 2017 janë shfrytëzuar 216,798.50 ton plumb dhe zink (minerale metalike), 624,557.87 ton nikel dhe kobalt dhe 7,574,697.00 ton minerale energjetike (qymyr).

Ndërkaq gjatë vitit 2018 sasia e shfrytëzimit të këtyre mineraleve është ulur. Gjatë këtij viti janë shfrytëzuar 173,243.96 ton plumb dhe zink (minerale metalike), 431,630.06 ton nikel dhe kobalt dhe 7,169,767.00 ton minerale energjetike (qymyr).

Ndërsa gjatë vitit 2019 është vërejtur ulje e theksuar e shfrytëzimit të nikelit dhe kobaltit dhe rritje e shfrytëzimit të qymyrit. Gjatë këtij viti janë shfrytëzuar 204,079.00 ton plumb dhe zink (minerale metalike), 305,012.48 ton nikel dhe kobalt, si dhe 8,063,051.00 ton minerale energjetike (qymyr).¹⁰

SHUMA E TË HYRAVE TË INKASUAR NGA KOMPANITË MINERARE NË BUXHETIN E SHTETIT (2017,2018 DHE 2019)

Gjatë periudhës tre vjeçare (2017,2018 dhe 2019) nga veprimtaritë e kompanive minerare në Buxhetin e Republikës së Kosovës janë derdhur gjithsej 87,707,503.11 euro. Shuma e të hyrave të inkasuara për secilin vit dhe pjesëmarrja e këtyre shumave në buxhetin e shtetit për vitet përkatëse është paraqitur në tabelën e mëposhtme.


	Të hyrat e inkasura në Buxhetin e Republikës së Kosovës nga kompanitë minerare:	Pjesëmarrja e këtyre të hyrave në Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitet përkatëse:
Në vitin 2017:	31,229,252.37 €.	1.56 %
Në vitin 2018:	26,024,451.05 €.	1.25%
Në vitin 2019	30,453,799.69 €.	1.28%
Gjithsej	87,707,503.11 €	

Figura nr.2. Shuma e të hyrave të inkasuara nga veprimtaritë e kompanive minerare gjatë viteve 2017, 2018 dhe 2019.

⁹ Raporti Vjetor i Komisionit për Miniera dhe Minerale, 2019.

¹⁰ Të dhëna të marra nga raportet vjetore të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale.

Gjatë vitit 2017 nga veprimtaritë e kompanive minerare në Buxhetin e Republikës së Kosovës janë derdhur 31,229,252.37 euro. Kjo shumë e të hyrave të inkasuara bën pjesë në 1.56 % të buxhetit fillestar për vitin 2017.




■ Të hyrat nga kompanitë minerare (2017) ■ Buxheti i Republikës së Kosovës (2017)

Figura nr. 3. Pjesëmarrja e veprimtarisë së minierave dhe mineraleve në Buxhetin e Shtetit, për vitin 2017.

Shuma e përgjithshme mjeteve të paguara nga ana e kompanive minerare në Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2017 është arritur nga: a) taksat administrative (454,371.00 euro), b) gjjobat administrative (203,012.00 euro), c) renta minerare (30,570,476.00 euro), ç) depozitat (10,000.00 euro) dhe d) kthimi i mjeteve (1,394.00 euro).¹¹

¹¹ Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, Raporti Vjetor për vitin 2017.

Gjatë vitit 2018 nga veprimtaritë e kompanive minerare Buxheti i Republikës së Kosovës ka akumuluar shumën e mjeteve prej 26,024,451.05 euro.¹² Kjo shumë e të hyrave të inkasuara bën pjesë në 1.25 % të buxhetit fillestar për vitin 2018.




■ Të hyrat nga kompanitë minerare (2018) ■ Buxheti i Republikës së Kosovës (2018)

Figura 4. Pjesëmarrja e veprimtarisë së minierave dhe mineraleve në Buxhetin e Shtetit, për vitin 2018.

Shuma e përgjithshme e të hyrave nga kompanitë minerare për vitin 2018 është arritur nga: a) taksat administrative (425.634,98 euro), b) gjobat administrative (344,204.88 euro), c) renta minerare (25,233,911.19 euro), ç) depozitat (25,000.00) dhe d) kthimi i mjeteve (4,300.00 euro).¹³

Në vitin 2019 nga operimi i kompanive minerare në Buxhetin e Republikës së Kosovës janë derdhur 30,453,799.69 euro. Kjo shumë e të hyrave të inkasuara bën pjesë në 1.28 % të buxhetit fillestar të paraparë për vitin 2019.



■ Të hyrat nga kompanitë minerare (2019) ■ Buxheti i Republikës së Kosovës (2019)

Figura 5. Pjesëmarrja e veprimtarisë së minierave dhe mineraleve në Buxhetin e Shtetit, për vitin 2019.

Shuma e përgjithshme e të hyrave nga kompanitë minerare për vitin 2019 është arritur nga: a) taksat administrative (552,142.07 euro), b) gjjobat administrative (511,503.42 euro), c) renta minerare (29,385,154.20 euro) dhe ç) depozitat (5,000.00 euro).¹⁴

¹² Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, Raporti Vjetor për vitin 2018.

¹³ Komisioni i Pavarur për Media dhe Minerale, Raporti Vjetor 2018.

¹⁴ Të dhëna të marrura nga përgjigja e Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale në Kërkesën për Qasje në Dokumente Publike.

Raporti vjetor i Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPMM) për vitin 2020 nuk është publikuar ende, mirëpo sipas drejtorit të këtij institucioni, Ramiz Krasniqi, gjatë kësaj periudhe KPMM qëndron mirë më të hyra. Sipas tij, KPMM ka punuar edhe gjatë pandemisë dhe për vitin 2020 ka realizu të hyra afër 30 milion euro.¹⁵

LIRIMI I PAGESËS SË RENTËS MINERARE

Ligji (Nr. 07/L-016) për Rimëkëmbje Ekonomike, qëllimi i të cilit është mundësimi i rimëkëmbjes së ekonomisë pas efekteve negative të shkaktuar nga Covid-19, quditërisht është përkujdesur edhe për kompanitë minerare.

Ligji i propozuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës dhe i sjellur nga Kuvendi i Republikës së Kosovës në dhjetor të vitit 2020, është komentuar nga shumë akterë, të cilët lirimin pagesës që e parasheh ky ligj e shohin si të panevojshëm.

Neni 14 i këtij ligji parasheh se “me qëllim të rimëkëmbjes ekonomike lirohen nga pagesa e rentës minerare prej datës 1 janar 2021 deri me 31 maj 2021 të gjitha subjektet që obligohen të paguajnë këtë rentë”.¹⁶

Pra sipas kësaj dispozite, në 5 muajt e parë të vitit 2021, kompanitë minerare nuk kanë nevojë të paguajnë fare për resurset që i shfrytëzojnë nga shteti.

Lirimi nga pagesa e rentës minerare për 229 kompani do ta dëmtojë buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin e ardhshëm për afro 15 milionë euro.¹⁷

Në lidhje me këtë, Drejtori i Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPMM), Ramiz Krasniqi, ka deklaruar se kompanitë që do të lirohen nga renta minerare nuk janë kufizuar për të punuar për shkak të pandemisë. Sipas Krasniqit, në këtë rast më së shumti përfiton KEK-u, që për këtë periudhë do të kishte paguar 7-8 milion.¹⁸

¹⁵ Për më tepër, shih: Deputeti arsyeton propozimin e tij që gurthyesve t'u hiqet taksa (kallxo.com)

¹⁶ Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Ligji Nr. 07/L-016 për Rimëkëmbjen Ekonomike - COVID-19, neni 14.

¹⁷ Për më tepër, shih: Mospagesa e rentës minerare dëmton buxhetin me afro 15 milionë euro - Buletini Ekonomik

¹⁸ Për më tepër, shih: Deputeti arsyeton propozimin e tij që gurthyesve t'u hiqet taksa (kallxo.com) .

¹⁹ Po aty.

NUMRI I LICENCEVE DHE LEJEVE TË LËSHUARA PËR KOMPANITË MINERARE (2017,2018 DHE 2019)

Gjatë periudhës trevjeçare (2017,2018 dhe 2019) Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale kishte lëshuar gjithsej 627 leje dhe licenca për veprimtaritë e kompanive minerale dhe kishte refuzuar gjithsej 200 kërkesa për dhënien e këtyre lejeve dhe licencave.

Numri dhe lloji i licencave të lëshuara, si dhe numri i kërkesave të refuzuara gjatë kësaj periudhe është paraqitur në tabelën në vijim.

Numri total i licencave të lëshuara për shfrytëzim gjatë vitit 2017,2018 dhe 2019:	114 licenca
Numri total i licencave të lëshuara për hulumtim gjatë vitit 2017,2018 dhe 2019:	Numri total i licencave të lëshuara për hulumtim gjatë vitit 2017,2018 dhe 2019
Numri total i lejeve të lëshuara për aktivitete të veçanta gjatë vitit 2017,2018 dhe 2019:	266 licenca
Numri total i kërkesave të refuzuara gjatë vitit 2017,2018 dhe 2019:	200 kërkesa
Numri i licencave të lëshuara në total për veprimtarinë e kompanive minerare gjatë viteve 2017, 2018 dhe 2019:	627 leje dhe licenca

Tabela 3. Numri, lloji i licencave dhe lejeve të lëshuara ose refuzuara gjatë periudhës tre vjeçare (2017,2018 dhe 2019).

Gjatë vitit 2017 për veprimtarinë e minierave dhe mineraleve janë lëshuar 186 leje dhe licenca. Prej tyre, 31 kanë qenë të lëshuara për shfrytëzim, 89 për hulumtim dhe 66 për aktivitete të veçanta. Ndërkaq për mos përmbushje të kushteve për licencim, gjatë vitit 2017 KPMM-ja ka refuzuar 70 kërkesa për licenca dhe leje (14 për shfrytëzim, 35 për hulumtim dhe 21 leje për aktivitete të veçanta).

Gjatë vitit 2018 janë lëshuar 186 licenca dhe leje për veprimtarinë e kompanive minerare. Prej tyre, 31 janë lëshuar për shfrytëzim, 89 për hulumtim dhe 66 për leje dhe aktivitete të veçanta. Ndërkaq për shkak të mos përmbushjes së kushteve për licencim, gjatë vitit 2018 janë refuzuar 70 kërkesa për licenca dhe leje (35 për hulumtim, 14 për shfrytëzim, dhe 21 leje për aktivitete të veçanta).

Gjate vitit 2019 janë lëshuar 255 leje dhe licenca për veprimtarinë e kompanive minerare. Prej tyre, 52 licenca janë lëshuar për shfrytëzim, 85 licenca për hulumtim dhe 118 leje për aktivitete të veçanta. Ndërkaq për shkak të mos përmbushjes së kushteve për licencim, gjatë vitit 2019 KPMM-ja ka refuzuar 60 kërkesa për licenca dhe leje (9 për shfrytëzim, 31 për hulumtim dhe 20 leje për aktivitete të veçanta).

Numri i lejeve dhe licencave të lëshuara gjatë vitit 2017:	186 leje dhe licenca
Numri i lejeve dhe licencave të lëshuara gjatë vitit 2018:	186 leje dhe licenca
Numri i lejeve dhe licencave të lëshuara gjatë vitit 2019:	255 leje dhe licenca

Tabela 4. Numri i licencave dhe lejeve të lëshuara gjatë vitit 2017,2018 dhe 2019.

REKOMANDIME

Duke marrë parasysh gjendjen dhe rrethanat aktuale në sektorin e minierave dhe mineraleve në territorin e Republikës së Kosovës, si dhe angazhimin institucional të organeve kompetente, mund të konkludojmë se rruga drejt një zhvillimi të gjithmbarshëm të këtij sektori është në një sfidë të vazhdueshme dhe që kërkon vëmendje të veçantë shtetërore. Në këtë raport përmbledhës jemi përpjekur që në mënyrë inkluzive të analizojmë dhe të ndajmë disa nga çështjet kryesore që kanë rëndësi mbi zhvillimin e aktiviteteve minerare dhe sfidat aktuale të organeve shtetërore.

Padyshim se problemet që e tangojnë sektorin mineral në Republikën e Kosovës janë të shumta. Nga të dhënat që janë paraqitur në këtë raport, mund të rekomandojmë disa çështje, për të cilat do të duhej që një varg mekanizmash të vihen në lëvizje. Rrjedhimisht, nga të gjeturat e kësaj përmbledhjeje rrjedhin këto rekomandime:

- Ndërmarrja e hapave konkret drejt forcimit të mekanizmit monitorues të sektorit mineral, me qëllim që institucionet e vendit të jenë sa më efikas lidhur me zgjidhjen e problemeve dhe sfidave që ka sektori mineral;
- Ndërtimi i një platforme të planifikimit efikas të shfrytëzimit të resurseve nga industria minerare;
- Në kuptim të rifreskimit të legjislacionit domestik me çështjet moderne juridike në sektorin mineral, harmonizimi i ligjeve pozitive të Republikës së Kosovës me legjislacionin e Bashkimit Evropian paraqitet si nevojë e domosdoshme pragmatike;
- Me qëllim të zhvillimit industrial të sektorit mineral, është e domosdoshme që institucionet shtetërore të lancojnë një fushatë të tërheqjes së investitorëve; Luftimi i operimit jo-formal paraqet një ndër parakushtet themelore që zhvillimi i sektorin mineral të jetë sa më i shpejtë dhe më i sigurtë. Kësisoj, rritja e bashkëpunimit ndër-institucional në parandalimin dhe ndalimin e operimeve të jashtëligjshme paraqet një hap që duhet ndërmarrë sa më parë,

duke marrë parasysh faktin se bazuar në raportet vjetore të KPMM-së, mbetet ende shqetësuese çështja e vonësës së shqyrtimit të lëndëve nga gjykatat kompetente për veprime të kompanive të pa licencua;

- Krijimi i kushteve dhe rritja e sigurisë në punë për punëtorët gjatë kryerjes së veprimtarive minerare. Si pasojë e mungesës së sigurisë në punë ata përballen me kushte dhe rrethana të pavolitshme, që shpeshherë përfundojnë me lëndime të rënda trupore dhe me fatalitet. Vetëm gjatë vitit 2019 në këtë sektor kanë humbur jetën 3 punëtorë.
- Zonat në të cilat gjenden resurset minerare duhet të mbrohen dhe jo të pengohet shfrytëzimi i tyre, duke ndërtuar objekte infrastrukturore dhe objekte të tjera në afërsi të tyre.

¹² Të dhëna të marrura nga Agjencia për Informim dhe Privatësi, përmes kërkesës për qasje në dokumente publike.

REFERENCAT:

Ligji 03/L-163 për Miniera dhe Minerale, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, 2010.

Ligji Nr. 05/L-062 për Siguri në Punë në Veprimtarinë Minerare, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, 2016

Strategjia Minerare e Republikës së Kosovës 2012-2025, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, 2012.

Ueb-faqja zyrtare e Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale, <https://www.kosovo-mining.org/resurset-minerale/vendburimet-minerale/>

Raporti Vjetor 2019 i Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale. https://www.kosovo-mining.org/wp-content/uploads/2020/10/Raporti-vjetor_KPMM_2019-shq.pdf

Raporti Vjetor 2018 i Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale. https://www.kosovo-mining.org/wp-content/uploads/2017/09/Raporti-vjetor_KPM_M_2018-shq.pdf

Raporti Vjetor 2017 i Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale. https://www.kosovo-mining.org/wp-content/uploads/2017/09/Raporti-vjetor_KPMM_2017-shqip.pdf